SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.

Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(me raportin e audituesve të pavarur)

Përmbajtje

	Faqe
Raporti i Audituesve të Pavarur	i- iii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e flukseve monetare	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	4
Shënime të pasqyrave financiare	5-18

KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri
+355(4)2274 524
al-office@kpmg.com
kpmg.com/al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për pronarin dhe drejtimin e
SICPA Security Solutions Albania sh.p.k

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të SICPA Security Solutions Albania sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

KPMG Albania Shpk, an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ("KPMG International"), a Swiss entity.
Document classification: KPMG Confidential

Registered in the National Registration Center with VAT Number J91619001D

Përgjegjësitë e Drejtimit në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

— Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

— Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

— Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

— Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

— Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Heris Jani
Audituës Ligjor

KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 3 gusht 2017

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016
(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	2016	2015
AKTIVET			
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	248,509,377	305,639,351
Aktive afatgjata jomateriale	7	13,728	37,261
Aktive tatimore të shtyra	8	26,436,262	32,273,841
		274,959,367	**337,950,453**
Aktivet afatshkurtra			
Inventari	9	121,377,113	140,885,178
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	10	141,867,817	17,815,012
Parapagime dhe aktive të tjera	11	7,159,703	7,627,118
Mjete monetare dhe ekuivalentë	12	27,844,666	55,593,539
		298,249,299	**221,920,847**
Totali i aktiveve		**573,208,666**	**559,871,300**
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	17	466,337,321	466,337,321
Humbje të akumuluara		(287,967,744)	(490,608,578)
		178,369,577	**(24,271,257)**
DETYRIMET			
Detyrimet afatgjata			
Huatë - pjesa afatgjatë	13	-	391,248,000
Provizionet	6	534,795	455,965
		534,795	**391,703,965**
Detyrimet afatshkurtra			
Huatë - pjesa afatshkurtër	13	197,389,401	8,097,168
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	14	152,969,381	120,353,570
Tarifa e koncesionit e pagueshme	15	16,215,798	17,190,658
Tatim fitimi per tu paguar	25	9,291,657	11,122,574
Detyrime të tjera	16	18,438,057	35,674,622
		394,304,294	**192,438,592**
Totali i detyrimeve		**394,839,089**	**584,142,557**
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		**573,208,666**	**559,871,300**

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 5 deri më 19 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi i Drejtorëve të SICPA Security Solutions Albania Sh.p.k më datë 18 korrik 2017 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Xavier Davard
Administrator

Juliana Mali
Manaxhere e Finances dhe
Burimeve Njerezore

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	2016	2015
Të ardhura operative	18	820,126,542	851,268,693
Kosto e mallrave të shitur	20	(339,942,959)	(353,522,320)
Fitimi bruto		**480,183,583**	**497,746,373**
Të ardhura të tjera	19	3,391,932	6,047,642
Të ardhura të tjera		**3,391,932**	**6,047,642**
Furnizime dhe shërbime	21	(115,066,425)	(113,055,391)
Shpenzime për personelin	22	(132,364,636)	(137,185,634)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	6	(67,916,548)	(193,042,967)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	7	(23,533)	(23,533)
Honorare për të drejtat e autorit	23	(42,640,911)	(45,195,565)
Tarifa e koncesionit	15	(16,215,798)	(17,190,658)
Shpenzime operative		**(374,227,851)**	**(505,693,748)**
Fitimi / (humbja) operativ/(e)		**109,347,664**	**(1,899,733)**
Të ardhura financiare		5,338,809	12,225,279
Shpenzime financiare		(27,066,733)	(39,176,629)
Shpenzime financiare, neto	24	**(21,727,924)**	**(26,951,350)**
Fitimi/(humbja) para tatimit		**87,619,740**	**(28,851,083)**
Shpenzimi i tatim - fitimit	25	(25,620,491)	(1,092,592)
Fitimi / (humbja) për vitin		**61,999,249**	**(29,943,675)**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Të ardhura/(humbje) gjithëpërfshirëse për vitin		**61,999,249**	**(29,943,675)**

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e në faqet 5 deri 18 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	2016	2015
Flukse monetare nga veprimtaritë operative			
Fitimi/(humbja) para tatimit		87,619,740	(28,851,083)
Rregullime për:			
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	6	67,916,548	193,042,967
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	7	23,533	23,533
Humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimi të aktiveve	21	-	33,899
Rënie në vlerë e inventarëve	9	69,476	303,286
Nxjerrje jashtë përdorimit e inventarëve	9	2,486,149	5,045,752
Fitime nga kursi i këmbimit		(3,195,300)	(8,316,000)
Efekti i skontimit të provizionit	6	78,830	37,277
Shpenzime për interesin	24	26,285,732	38,241,900
Të ardhura nga interesi	24	(64)	(708)
		181,284,644	**199,560,823**
Ndryshime në:			
Inventar		16,952,440	50,863,866
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera		16,588,780	7,147,509
Parapagime dhe aktive të tjera		467,415	(613,235)
Llogari të pagueshme tregtare		32,615,811	(57,100,688)
Tarifa e koncesionit e pagueshme		(974,860)	(125,459)
Detyrime të tjera		(17,236,565)	19,450,493
Mjete monetare realizuar nga veprimtaritë operative		**229,697,665**	**219,183,309**
Interes i paguar		(30,372,399)	(40,006,264)
Tatim-fitimi i paguar (shënimi 25)		(21,613,829)	-
Mjete monetare neto nga veprimtaritë operative		**177,711,437**	**179,177,045**
Flukse monetare nga veprimtaritë investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	6	(10,786,574)	(53,647,444)
Interes i arkëtuar		64	708
Mjete monetare neto përdorur në veprimtaritë investuese		**(10,786,510)**	**(53,646,736)**
Flukse monetare nga veprimtaritë financuese			
Pagesë huaje		(194,673,800)	(97,933,000)
Mjete monetare neto përdorur në veprimtaritë financuese		**(194,673,800)**	**(97,933,000)**
(Pakësimi)/rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalente		**(27,748,873)**	**27,597,309**
Mjete monetare dhe ekuivalente më 1 janar		**55,593,539**	**27,996,230**
Mjete monetare dhe ekuivalente më 31 dhjetor	12	**27,844,666**	**55,593,539**

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet e në faqet 5 deri 18 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Pasqyra ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali i nënshkruar	Humbjet e akumuluara	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	**466,337,321**	**(460,664,903)**	**5,672,418**
Humbja për vitin	-	(29,943,675)	**(29,943,675)**
Humbja gjithëpërfshirëse për vitin	**-**	(**29,943,675)**	**(29,943,675)**
Gjendja më 31 dhjetor 2015	**466,337,321**	**(490,608,578)**	**(24,271,257)**
Fitimi për vitin	-	61,999,249	**61,999,249**
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	**-**	**61,999,249**	**61,999,249**
Kontribut për fazën e nisjes së aktivitetit (shënimi 10)		140,641,585	**140,641,585**
Gjendja më 31 dhjetor 2016	**466,337,321**	**(287,967,744)**	**178,369,577**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e në faqet 5 deri 18 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1 Informacion i përgjithshëm

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k. ("SICPA" ose "Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) më 20 shtator 2010 me NIPT L02120032R.

Veprimtaria e Shoqërisë konsiston në implementimin e Marrëveshjes së Koncesionit për Shërbim ('Marrëveshja e Koncesionit') të lidhur midis Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë ('Autoriteti') për printimin, prodhimin dhe furnizimin e pullave fiskale si dhe veprimtari të tjera në zbatim të Marrëveshjes së Koncesionit si krijimi dhe mirëmbajtja e një Godine Prodhimi Qendrore në ambientet që do të caktohen nga Autoriteti: projektimin, zhvillimin, financimin, testimin, vënien në punë dhe mirëmbajtjen e sistemit, Sistemin Qendror të Gjurmimit dhe Monitorimit dhe Njësitë Kompjuterike gjatë periudhës së marrëveshjes. Koncesioni është dhënë për një afat prej 10 vitesh duke filluar që nga data në të cilën kontrata hyn në fuqi ('Data efektive').

Marrëveshja e Koncesionit nuk u be plotësisht efektive gjatë vitit 2016, pasi u shty nga Autoriteti, dhe Shoqëria nuk ka marrë ndonjë konfirmim nga Autoriteti mbi datën efektive.

SICPA Security Solutions Albania zotërohet 100% nga SICPA SA me vendndodhje në Zvicër (shoqëria mëmë) dhe është pjesë e Grupit SICPA. Shoqëria mëmë përfundimtare është SICPA Holding SA.

Administratori i Shoqërisë është Z. Xavier Davard.

Selia e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në Kashar, Rruga Gryka e Kacanikut, Autostrada Tiranë – Durrës, Km 5, SH2, Tiranë, Shqipëri.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016 ishte 40 (2015: 43).

2 Baza e kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë

Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria kishte humbje të akumuluara në vlerën e 287,967,744 Lek (2015: 490,608,578 Lek). Kjo është më shumë pasojë e fazës së nisjes së aktivitetit si edhe e shtyrjes së datës efektive të Marrëveshjes së Koncesionit (shënimi 1), e cila lidhet kryesisht me shtyrjen e prodhimit të pullave farmaceutike. Për të përmbushur nevojat për kapital dhe likuiditet dhe për të vijuar operacionet, Shoqëria ka marrë nga shoqëritë e Grupit SICPA hua në vlerën 345,402,630 Lek (2015: 513,367,973 Lek) (shënimi 27). Në janar 2017, Shoqëria shtyu afatin e marrëveshjes së huasë me SICPA SA deri në 2018 (shënimi 28), ndërkohë që gjatë vitit 2016, Shoqëria faturoi për SICPA SA një shumë prej 140,641,585 Lek, që përfaqësonin kontribute në mbështetje të humbjeve gjatë fazës së nisjes së Shoqërisë për vitet 2014 dhe 2015 (shënimet 10 dhe 28).

Shoqëria nuk ka ndërmend të likuidojë apo të ndërpresë aktivitetin e saj gjatë vitit 2017. Drejtimi i grupit konfirmon angazhimin për të vazhduar mbështetjen ndaj Shoqërisë. Gjithashtu, gjatë 2016 Shoqëria realizoi një fitim neto prej 61,999,249 Lek, dhe flukse monetare pozitive nga veprimtaria operative prej 177,711,437 Lek. Drejtimi mendon se Shoqëria do të jetë e aftë të realizojë fitime në të ardhmen dhe nuk do të cënohet parimi i vijimësisë. Ndaj, Shoqëria ka përgatitur këto pasqyra financiare bazuar në parimin e vijimësisë.

3 Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kryesore kontabël që janë përdorur në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare paraqiten si më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë konsistente për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa vlerësimeve të rëndësishme kontabël dhe kërkon gjithashtu që drejtimi të ushtrojë gjykimin e vet gjatë zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë.

Çështjet që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi, apo ndërlikimi, apo ato për të cilat supozimet dhe vlerësimet kanë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 5.

Standarde të reja të publikuara, por ende jo efektive

Disa standarde të reja dhe ndryshime të standardeve ekzistuese janë në fuqi për periudha vjetore që fillojnë pas 1 janarit 2016, me zbatim të mëhershëm të lejuar; megjithatë Shoqëria nuk ka zbatuar në mënyrë të mëhershme standardet e reja ose të ndryshuara si më poshtë në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

SNRF 15, Të ardhurat nga Kontratat me Klientët

Standardi i ri paraqet parimin bazë se të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet janë transferuar tek klientët, me çmimin e transaksionit. Çfarëdo mallra apo shërbime të paketuara të cilat janë të dallueshme duhet të njihen veçmas, dhe uljet apo zbritjet e çmimit duhet të ndahen në elementët përkatës. Kur pagesa ndryshon për ndonjë arsye, duhet të njihet një shumë minimale nëse nuk ka rrezik domethënës për kthim. Shpenzimet e kryera për të siguruar kontrata me klientë duhet të kapitalizohen dhe amortizohen gjatë periudhës kur konsumohen përfitimet përkatëse.

Ndryshimet e publikuara më 12 prill dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 nuk ndikojnë parimet bazë të standardit, por qartësojnë mënyrën se si këto parime duhet të vihen në zbatim. Ndryshimet sqarojnë si të identifikohet një detyrim për performancë (premtimi për të transferuar një mall apo shërbim tek një klient) në një kontratë; si të bëhet dallimi nëse një shoqëri është njësi kryesore (dhënësi i një malli apo shërbimi) apo një ndërmjetës (përgjegjës për të rregulluar dhënien e mallit apo shërbimit); dhe si të dallohet nëse të ardhurat nga dhënia e një licence duhet të njihen në një moment të caktuar apo të shpërndahen në disa periudha. Përveç qartësimeve, ndryshimet përfshijnë dy lehtësime shtesë në uljen e kostove dhe ndërlikimeve për një shoqëri e cila e zbaton për herë të parë Standardin.

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.1 Baza e përgatitjes (vazhdim)

Standarde te reja të publikuara, por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 15, Të ardhurat nga Kontratat me Klientët (vazhdim)

Aktualisht Drejtimi është duke vlerësuar ndikimin e zbatimit të standardit të ri në pasqyrat financiare në lidhje me të ardhurat nga shitja e pullave fiskale dhe transporti. Megjithatë, një vlerësim më i detajuar i ndikimit do të bëhet në periudhat e ardhshme.

SNRF 9, Instrumentet financiarë

SNRF 9, i publikuar në korrik 2014 zëvendëson interpretimet ekzistuese në SNK 39 Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja. SNRF 9 përfshin interpretime të rishikuara në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, përfshirë një model të ri të humbjes së pritur të kreditit për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kërkesat e reja të kontabilitetit të mbrojtjes. Gjithashtu përfshin interpretime për njohjen dhe çregjistrimin e instrumenteve financiare nga SNK 39. SNRF 9 është efektiv për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më ose pas 1 janar 2018 me mundësinë e aplikimit të mëhershëm.

Për shkak të llojeve të instrumenteve financiare të mbajtura nga Shoqëria, standardi i ri nuk pritet të ketë një ndikim material për periudhat aktuale ose për periudhat e ardhshme të raportimit apo edhe në transaksionet e ardhshme të parashikueshme.

SNRF 16, Qiratë

SNFR 16 u publikua më 13 janar 2016 dhe hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2019. Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, pasqyrimin dhe informacionet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë i japin të drejtën qiramarrësit të përdorë një aktiv në fillim të periudhës së qiradhënies dhe nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës, i mundësojnë dhe marrje financimi. Për rrjedhojë, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirasë si qira operative apo financiare, sipas kërkesës nga SNK 17 dhe në vend të saj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qirasë. Qiramarrësit do t'i kërkohet të njohë: (a) aktive dhe detyrime për të gjitha kontratat e qirasë me një afat prej më shumë se 12 muaj, përveç rasteve kur aktivi bazë është me vlerë të ulët; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të dhëna me qira veçmas nga interesi në detyrimet e qirasë në pasqyrën e të ardhurave. SNRF 16 në thelb mbart kërkesat kontabël të qiradhënësit në SNK 17. Kështu, një qiradhënës vazhdon t'i klasifikojë qiradhëniet e tij si qira operative ose financiare dhe do t'i kontabilizojë këto dy lloje në mënyra të ndryshme.

Aktualisht Shoqëria është duke vlerësuar ndikimin në pasqyrat financiare të ndryshimeve nga aplikimi i SNRF 16.

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare të Shoqërisë janë matur me monedhën e mjedisit ekonomik në të cilin operon Shoqëria ('monedha funksionale'). Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ('Lek'), që është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

Transaksionet dhe gjendjet

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve ose të rivlerësimeve në rastin e zërave që rivlerësohen. Fitimet dhe humbjet nga ndryshimi i kursit të këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga konvertimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit njihen në fitime ose humbje.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit paraqiten neto në fitim ose humbje.

3.3 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin, nëse ka.

Kostoja përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës së drejtpërdrejtë (nëse ka), kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për një qëllim të caktuar dhe koston e çmontimit si dhe të heqjes së pajisjeve dhe rikthimin në gjendje normale të vendit ku ishte ngritur aktivi.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Në bazë të Marrëveshjes së Koncesionit një pjesë e makinerive dhe pajisjeve teknike mbeten në pronësi të Shoqërisë por u jepen në përdorim pa pagesë dhe instalohen pranë ambienteve të klientëve të cilët i përdorin për prodhimin e pullave fiskale.

Kostot e mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të zërit nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese do të rrjedhin në Shoqëri dhe kosto e pjesës mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Kostot e mëpasshme (vazhdim)

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material përcaktohen nga krahasimi i vlerës së arkëtuar nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbartur të aktivit dhe njihen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi

Amortizimi ngarkohet në fitim ose humbje në bazë të metodës lineare, përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale nga momenti kur është i gatshëm për përdorim. Përmirësimet e ambienteve të marra me qira amortizohen mbi bazën e afatit më të shkurtër kohor ndërmjet periudhës së marrjes me qira dhe jetëgjatësisë së tyre.

Jetëgjatësitë e vlerësuara të aktiveve afatgjata materiale për periudhat aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Përmirësimet e kryera në ambientet me qira	Afati i qirasë
Instalime	5 vite
Pajisje zyre	5 vite
Kompjuterë dhe pajisje IT	4 vite
Makineri e pajisje teknike	5 vite në 2015 dhe 5-10 vite në 2016

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Gjatë vitit 2016, jetëgjatësia e vlerësuar për disa zëra të makinerive dhe pajisjeve u rishikua (shënimi 6.(i)).

3.4 Aktive afatgjata jo-materiale

Licencat e blera të programeve kompjuterike janë kapitalizuar në bazë të shpenzimeve të bëra për të blerë dhe për të vënë në përdorim programe të veçanta. Këto shpenzime janë amortizuar në bazë të metodës lineare me jetëgjatësi 4 vite.

3.5 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohen për zhvlerësim sa herë që ka ngjarje ose ndryshime në rrethana të cilat tregojnë se vlera e mbartur e tyre nuk mund të jetë e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet për vlerën me të cilën vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktivi pas zbritjes së shpenzimeve të shitjes dhe vlerës në përdorim të tij. Për qëllime të përcaktimit të zhvlerësimit, aktivet grupohen në grupet më të vogla të mundshme për të cilat flukset monetare identifikohen lehtësisht (njësi gjeneneruese të parasë).

3.6 Instrumente financiare

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivative, duke përfshirë të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalente me to, kredi dhe hua, llogari të pagueshme tregtare dhe të pagueshme tjera.

Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentet jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, çdo kosto që lidhet me transaksionet në mënyre të drejtpërdrejtë, përveç siç është përshkruar më poshtë. Pas njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivative maten siç është përshkruar më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë për flukset monetare nga aktivet financiare ose nëse Shoqëria transferon aktivet financiare tek një palë tjetër, pa mbajtur kontroll mbi to, ose transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet normale dhe shitjet e aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet për të blerë ose shitur aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuara në kontratë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë

Mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë para në arkë, depozita pa afat të mbajtura në bankë, investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturim origjinal prej tre muajsh ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë e më pas me kosto të amortizuar.

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi

Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera paraqiten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar.

Huadhëniet dhe huamarrjet

Huadhëniet dhe huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare, huadhëniet dhe huamarrjet paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në fitime ose humbje çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Tarifa e koncesionit e pagueshme

Shoqëria detyrohet t'i paguajë Autoritetit për të drejtat dhe privilegjet e caktuara me Marrëveshjen e Koncesionit një tarifë koncesioni prej 2% mbi të ardhurat vjetore neto nga shitja e pullave fiskale, bazuar në pasqyrat financiare të audituara të Shoqërisë për çdo vit financiar. Tarifa e koncesionit e pagueshme ndaj Autoritetit regjistrohet si detyrim financiar në momentin e njohjes së të ardhurave neto nga shitja e pullave fiskale. Ato maten me vlerën e drejtë të pagueshme ndaj Autoritetit.

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.7 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parashikuara të aktivit.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën fillestare efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera të mbetura financiare vlerësohen kolektivisht, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitime ose humbje.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në fitime ose humbje.

3.8 Inventarët

Inventarët paraqiten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto përcaktohet duke përdorur metodën e kostos standarde dhe përbëhet nga kostot e materialeve, punës, kosto të tjera të drejtpërdrejtë dhe shpenzime të lidhura me prodhimin. Analiza periodike kryhen nga Shoqëria për të krahasuar koston aktuale kundrejt kostos standarde dhe diferencat e dala nga analiza të tilla regjistrohen si "kosto e mallrave të shitura". Vlera neto e realizueshme është çmimi fiks i shitjes për njësi siç është përcaktuar në Marrëveshjen e Koncesionit, duke zbritur kostot e vlerësuara të përfundimit dhe kostot e vlerësuara të nevojshme për të realizuar shitjen.

3.9 Kapitali i nënshkruar

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

3.10Tatim-fitimi dhe tatimi i shtyrë

Shpenzimi i tatimit- fitimin përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi- fitimin njihet në fitime ose humbje përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen në kapital apo në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi mbi të ardhurat e periudhës llogaritet në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi në datën e raportimit. Periodikisht nga Drejtimi bëhen vlerësime të pozicionit të detyrimeve tatimore sipas formularëve të deklarimit në përputhje me interpretimet dhe rregullat tatimore. Drejtimi vendos mbi provizionet për t'u krijuar mbi bazën e shumave të pritshme për t'u paguar ndaj autoriteteve tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi ose thelbësisht në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin i shtyrë njihet deri në atë masë ku mund të pritet që në të ardhmen të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme për realizimin e diferencave të përkohshme. Aktivet nga tatimet e shtyra rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në rastet kur nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e një pozicioni tatimor të paqartë dhe gjithashtu mundësinë e rritjes së detyrimit tatimor dhe interesave. Shoqëria beson se njohja e detyrimeve fiskale është e përshtatshme për vitet në vazhdim pasi është bazuar në vlerësimin e një sërë faktorësh, përfshirë interpretimin e ligjit tatimor si dhe eksperiencave të mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në një sërë vlerësimesh dhe supozimesh që përfshijnë gjykime lidhur me ngjarje të ardhshme. Informacione të reja mund të shkaktojnë ndryshime në gjykimin e Shoqërisë lidhur me përshtatshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; të tilla ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore të periudhës kur u mor ky vendim.

3.11 Përfitimet e punonjësve

Kontributi për sigurime shoqërore, shëndetësore

Shoqërisë i kërkohet nga legjislacioni aktual shqiptar që të derdhë kontribute të caktuara për të punësuarit në një fond sigurimesh shoqërore që drejtohet nga shteti shqiptar. Të gjithë pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

3.12 Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, kur ekziston mundësia e flukseve dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer detyrimet, dhe kur vlera e detyrimit mund të përcaktohet më vërtetësi. Provizionet nuk njihen për humbjet e ardhshme operative.

Provizionet maten me vlerën aktuale të skontuar të shpenzimeve të pritshme për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë skontimi para tatimit e cila pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Rritja në provizione si pasoje e kalimit të kohës njihet si shpenzime për interesa.

Provizionet rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese dhe rregullohen për të pasqyruar çmuarjen më të mirë aktuale. Nëse nuk është më e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike kërkohet për të shlyer detyrimin, atëherë provizioni rimerret.

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.13 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto nga përfitimet ekonomike gjatë periudhës që vijnë si rrjedhim i aktiviteteve normale të subjektit kur këto flukse rezultojnë në rritje të kapitalit, të ndryshme nga rritjet të cilat vijnë si rrjedhojë e kontributit nga ortakët. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të pagesave të marra ose të arkëtueshme për shitjen e mallrave / shërbimeve gjatë aktivitetit normal të Shoqërisë. Të ardhurat paraqiten neto nga TVSH-ja, kthimet, uljet për nivele shitjesh dhe zbritjet. Për aktivitete tregtare normale të Shoqërisë, të ardhurat nga shitja njihen në datën e lëvrimit të produktit final drejt klientit.

Shoqëria i njeh të ardhurat kur shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme, kur është e mundur që Shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, dhe kur përmbushen kritere të caktuara. Shuma e të ardhurave nuk konsiderohet si e vlerësuar në mënyrë të besueshme deri në momentin kur të gjitha pasiguritë në lidhje me shitjen të jenë zgjidhur.

Të ardhura të tjera

Të ardhurat tjera përfshijnë të ardhurat në rrjedhën normale të veprimtarisë së Shoqërisë (fitimet nga nxjerrje jashtë përdorimit, pagesat e sigurimeve të marra për dëmet e shkaktuara etj.).

3.14 Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat dhe kostot financiare përbëhen nga të ardhurat dhe shpenzimet e interesit, efekti i skontimit të provizionit dhe fitimet ose humbjet nga këmbimi në monedha të huaja. Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi në monedha të huaja paraqiten për shumën neto.

3.15 Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra për qiratë operative (neto nga stimuj që vijnë prej qiradhënësit) janë ngarkuar në fitim ose humbje mbi bazën e metodës lineare përgjatë periudhës së kohëzgjatjes së qirasë.

4 Menaxhimi i rrezikut financiar

4.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e Shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare: rreziku i tregut (duke përfshirë rrezikun valutor dhe rrezikun e normës së interesit), rreziku i kreditit dhe rreziku i likuiditetit. Programi i përgjithshëm i Shoqërisë për menaxhimin e rrezikut fokusohet në vendosjen e kufijve të ekspozimeve ndaj rreziqeve të ndryshme.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes që rezulton nga ndryshimet në normat e këmbimit valutor dhe nga normat e interesit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar në një moment të dhënë kohe ndryshon në varësi të kushteve të tregut, të ligjeve dhe rregulloreve të nxjerra nga Autoriteti si dhe të pritshmërive për lëvizjet e ardhshme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit të tregut.

Drejtimi vendos kufi për vlerën e rrezikut që mund të pranohet, nivel që monitorohet çdo muaj. Megjithatë, përdorimi i kësaj metode nuk i parandalon humbjet përtej këtyre kufijve në kushtet e lëvizjeve të mëdha në treg.

(i) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria vepron dhe është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që rrjedh nga ekspozimet në monedhë në lidhje me Euron.

Rreziku i kursit të këmbimit lind kur transaksionet e ardhshme tregtare ose aktive dhe detyrime të njohura janë në një monedhë që nuk është monedha funksionale e subjektit. Në lidhje me rrezikun e monedhës, Drejtimi vendos kufij mbi nivelin e ekspozimit ndaj çdo monedhe dhe në total. Pozicionet monitorohen çdo muaj.

Shoqëria nuk ka hyrë në transaksione mbrojtëse për ekspozimin ndaj rrezikut valutor pasi nuk pret humbje të rëndësishme për shkak të alternimeve në normat e monedhës krahasuar me atë ekzistuese në datën e raportimit.

Kurset e këmbimit për Euron shprehur në Lek për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit janë më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Euro	135.23	137.28

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 ishte si më poshtë:

		Ekuivalentët në Lek	
31 dhjetor 2016	**Lek**	**Euro**	**Totali**
Aktive financiare			
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 10)	-	141,867,817	141,867,817
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente (shënimi 12)	120,684	27,723,982	27,844,666
	120,684	**169,591,799**	**169,712,483**
Detyrime financiare			
Huamarrje (shënimi 13)	-	(197,389,401)	(197,389,401)
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 14)	(1,767,836)	(151,201,545)	(152,969,381)
Tarifa e koncesionit e pagueshme (shënimi 15)	(16,215,798)	-	(16,215,798)
	(17,983,634)	**(348,590,946)**	**(366,574,580)**
Rreziku i kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2016	**(17,862,950)**	**(178,999,147)**	**(196,862,097)**

4 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.1 Faktorët e rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i tregut (vazhdim)

(i) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

	Ekuivalentët në Lek		
31 dhjetor 2015	**Lek**	**Euro**	**Totali**
Aktive financiare			
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 10)	-	17,815,012	17,815,012
Mjete monetare dhe ekuivalente (shënimi 12)	867,521	54,726,018	55,593,539
	867,521	**72,541,030**	**73,408,551**
Detyrime financiare			
Huamarrje (shënimi 13)	-	(399,345,168)	(399,345,168)
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 14)	(2,412,032)	(117,941,538)	(120,353,570)
Tarifa e koncesionit (shënimi 15)	(17,190,658)	-	(17,190,658)
	(19,602,690)	**(517,286,706)**	**(536,889,396)**
Rreziku i kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2015	**(18,735,169)**	**(444,745,676)**	**(463,480,845)**

Forcimi ose dobësimi i monedhës Lek me 10% kundrejt monedhës Euro më 31 dhjetor 2016 do të sillte rritje ose ulje në fitime ose humbje në shumën prej 17,899,915 Lek (2015: rritje ose ulje në shumën 44,474,568 Lek).

(ii) Rreziku i normës së interesit

Detyrimet e Shoqërisë që mbartin interes lidhen me kreditë e marra nga Ortaku dhe të ardhurat e Shoqërisë dhe flukset monetare operative nuk janë të ekspozuara në mënyrë të rëndësishme nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Norma e interesit e kredisë nga Ortaku është e fiksuar dhe ndonjë ndryshim në normat e interesit të tregut nuk do të kishte ndonjë efekt në pozicionin financiar të Shoqërisë.

Rreziku i kreditit

Shoqëria ndërmerr një ekspozim ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që një palë në një instrument financiar mund të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi.

Rreziku i kreditit lind nga mjetet monetare dhe ekuivalente me to, dhe nga depozitat në banka dhe institucionet financiare, si dhe nga ekspozimi i kredisë me klientët, duke përfshirë llogari të arkëtueshme dhe angazhime për transaksione.

Në 31 dhjetor 2016 dhe 2015 ekspozimi i Shoqërisë ndaj palëve të treta për llogaritë tregtare të arkëtueshme është minimal, sepse klientët e Shoqërisë parapaguajnë porositë para dorëzimit. Shumica e llogarive tregtare të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 janë të arkëtueshme nga shoqëritë e grupit SICPA. Shoqëria ka pak llogari të arkëtueshme dhe mjetet monetare janë depozituar pranë bankës Raiffeisen Bank në Shqipëri.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditeti përkufizohet si rreziku që Shoqëria do të përballet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me detyrimet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj kërkesave ditore lidhur me burimet e saj monetare, kryesisht për të shlyer shpenzimet operative gjatë aktiviteteve të saj rutinë. Drejtimi monitorin çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj parashikimin e vazhdueshëm të fluksit monetar të Shoqërisë.

Tabela më poshtë analizon aktivet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë sipas maturimit të tyre bazuar në periudhën e mbetur në datën e raportimit deri në datën e maturimit kontraktual. Shumat e paraqitura në tabelë janë flukse monetare kontraktuale të skontuara. Tepricat që shlyhen brenda 12 muajve barazojnë tepricat e mbartura pasi ndikimi i skontimit nuk është domethënës.

31 dhjetor 2016	**Deri 3 muaj**	**3 - 6 muaj**	**6 muaj - 1 vit**	**Mbi 1 vit**	**Totali**
Aktive financiare					
Llogari të arkëtueshme tregtare (shënimi 10)	-	-	141,867,817	-	141,867,817
Mjete monetare dhe ekuivalente (shënimi 12)	27,844,666	-	-	-	27,844,666
	27,844,666	**-**	**141,867,817**	**-**	**169,712,483**
Detyrime financiare					
Huamarrje (shënimi 13)	(4,010,501)	-	(193,378,900)	-	(197,389,401)
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 14)	-	-	(152,969,381)	-	(152,969,381)
Tarifa e koncesionit e pagueshme (shënimi 15)	-	(16,215,798)	-		(16,215,798)
	(4,010,501)	**(16,215,798)**	**(346,348,281)**	**-**	**(366,574,580)**
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2016	**23,834,165**	**(16,215,798)**	**(204,480,464)**	**-**	**(196,862,097)**

4 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.1 Faktorët e rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2015	Deri 3 muaj	3 - 6 muaj	6 muaj - 1 vit	Mbi 1 vit	Totali
Aktive financiare					
Llogari të arkëtueshme tregtare (shënimi 10)	14,759,972	15,960	3,039,080	-	17,815,012
Mjete monetare dhe ekuivalente (shënimi 12)	55,593,539	-	-	-	55,593,539
	70,353,511	**15,960**	**3,039,080**	**-**	**73,408,551**
Detyrime financiare					
Huamarrje (shënimi 13)	(8,097,168)	-	-	(391,248,000)	(399,345,168)
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 14)	-	-	(120,353,570)	-	(120,353,570)
Tarifa e koncesionit e pagueshme (shënimi 15)	-	(17,190,658)	-	-	(17,190,658)
	(8,097,168)	**(17,190,658)**	**(120,353,570)**	**(391,248,000)**	**(536,889,396)**
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2015	**62,256,343**	**(17,174,698)**	**(117,314,490)**	**(391,248,000)**	**(463,480,845)**

Në datën e raportimit, aktivet financiare monetare përbëhen nga të arkëtueshme tregtare dhe të tjera dhe mjete monetare, ndërsa detyrimet financiare monetare përbëhen nga llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera dhe hua afatgjata. Drejtimi beson se Shoqëria do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj duke përdorur arkëtimet nga të ardhurat dhe do të realizojë flukse pozitive të parasë. Përveç kësaj, shumica e detyrimeve janë me palët e lidhura dhe Drejtimi i Grupit ka deklaruar angazhimin për të vazhduar mbështetjen ndaj Shoqërisë (shënimi 2).

4.2 Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Shoqëria është krijuar vetëm për qëllimin e zbatimit të Marrëveshjes së Koncesionit. Sipas legjislacionit shqiptar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara duhet të ketë kontribute në kapital nga ortakët, por nuk kërkohet që të krijojë rezerva ligjore. Kapitali është kontribuar nga ortakët në mjete monetare. Kapitali përfshin vetëm kapitalin e regjistruar, të paguar dhe fitimet e akumuluara.

4.3 Vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një instrument financiar mund të shkëmbehet në një transaksion aktual midis palëve me vullnetin e tyre, dhe jo në një shitje ose likuidim të detyruar, dhe vërtetohet më mirë nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv.

Aktive financiare me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme konsiderohet se përafron me vlerën kontabël pasi ato janë instrumente afatshkurtra.

Detyrimet financiare me kosto të amortizuar

Vlera kontabël e llogarive të pagueshme konsiderohet se përafron me vlerën e drejtë. Vlerat kontabël të huave më 31 dhjetor 2016 përafrojnë me vlerën e drejtë për shkak të afatit të shkurtër të mbetur deri në maturim. Më 31 dhjetor 2015, vlerat kontabël të huave përafrojnë me vlerën e drejtë pasi interesat kontraktualë janë të përafërt me interesat e tregut.

5 Vlerësime dhe gjykime kritike

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen mbi eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë këtu pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Vlerësimet kontabël rezultuese, sipas përcaktimit, rrallë do të barazojnë rezultatet aktuale që kanë lidhje me to. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një risk domethënës për të shkaktuar një ndryshim material tek shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar trajtohen më poshtë.

Tatim-fitimi

Shoqëria i nënshtrohet tatim-fitimit në Shqipëri. Gjykim i rëndësishëm kërkohet për të përcaktuar shumën e tatimi-fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurt. Shoqëria i njeh detyrimet për kontrollin paraprak të tatimeve bazuar në vlerësimet nëse do të ketë detyrime për tatime shtesë. Nëse rezultati përfundimtar i tatimit për këto çështje është i ndryshëm nga shumat që janë regjistruar në fillim, këto ndryshime do të ndikojnë aktivet dhe detyrimet aktuale dhe të shtyra të tatimit mbi fitimin në periudhën në të cilën është bërë ky përcaktim.

Njohja e aktivit tatimor të shtyrë

Aktivi tatimor i shtyrë i njohur përfaqëson tatim-fitimin e përfitueshëm përmes zbritjeve të ardhshme nga fitimet e tatueshme, kryesisht në lidhje me zhvlerësimin e ndryshëm tatimor dhe kontabël të zbatuar për aktivet afatgjata materiale duke rezultuar në baza të tatueshme më të larta se vlerat kontabël të këtyre aktiveve. Aktivi tatimor i shtyrë njihet deri në atë masë që realizimi i përfitimit të tatimit është i mundshëm. Fitimet e tatueshme dhe shumat e përfitimeve tatimore të mundshme në të ardhmen bazohen në plan biznesin afatmesëm të përgatitur nga drejtimi dhe rezultatet e projektuara prej tij për vitin 2017. Plani i biznesit bazohet në pritshmëritë e drejtimit të cilat besohet se janë të arsyeshme duke konsideruar kushtet aktuale.

Zhvlerësimi aktiveve afatgjata materiale

Me gjithë shtyrjen e prodhimit të pullave farmaceutike dhe humbjet e akumuluara (shënimet 1 dhe 2), Drejtimi mendon se Shoqëria do të jetë e aftë të realizojë fitime në të ardhmen, bazuar në linja prodhimi të mjaftueshme për të realizuar këto fitime dhe flukse monetare operative pozitive. Vlerësimi i aktiveve afatgjata materiale është një çështje gjykimi e bazuar në eksperiencën, kushtet aktuale dhe pritshmëritë për të ardhmen.

Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale

Vlerësimi i jetëgjatësisë së aktiveve afatgjata materiale është një çështje gjykimi e bazuar në eksperiencën me aktive të tjera të ngjashme. Përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktive konsumohen së pari përmes përdorimit. Gjithsesi, faktorë të tjerë, siç janë konsumimi nga pikëpamja teknike dhe tregtare si dhe vjetërsimi, shpesh rezultojnë në pakësimin e përfitimeve ekonomike të trupëzuara në aktive. Drejtimi vlerëson jetëgjatësinë e mbetur në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e llogaritur gjatë së cilës ato priten të sjellin përfitime për Shoqërinë. Faktorët kryesorë të mëposhtëm janë marrë në konsideratë:

(a) përdorim i pritshëm i aktiveve;

(b) vjetërsimi i pritshëm fizik, i cili varet nga faktorët operacionalë dhe programi i mirëmbajtjes; dhe

(c) dalja nga përdorimi për sa i përket anës teknike dhe tregtare që lind nga ndryshimet në kushtet e tregut.

Drejtimi gjithashtu shqyrtoi që kriteret për zbatimin e KIRFN 12 'Marrëveshjet Koncesionoare të Shërbimit' nuk përmbushen në rastin e Marrëveshjes së Koncesionit dhe prandaj KIRFN 12 nuk është i zbatueshëm.

Gjatë 2016, Shoqëria rishikoi jetën e dobishme të disa zërave të aktiveve afatgjata materiale (shënimi 6.(i))

6 Aktive afatgjata materiale

	Përmirësime të ambienteve me qira	Instalime	Kompjuterë dhe pajisje zyre	Makineri e pajisje teknike	Totali
Kosto					
Më 1 janar 2015	**35,582,186**	**21,102,413**	**40,355,321**	**869,217,700**	**966,257,620**
Shtesa	73,142	8,750	2,308,263	51,257,289	53,647,444
Pakësime	**-**	**-**	(41,509)	**-**	(41,509)
Më 31 dhjetor 2015	**35,655,328**	**21,111,163**	**42,622,075**	**920,474,989**	**1,019,863,555**
Shtesa	-	458,380	6,702,166	3,626,028	10,786,574
Më 31 dhjetor 2016	**35,655,328**	**21,569,543**	**49,324,241**	**924,101,017**	**1,030,650,129**
Amortizimi i akumuluar					
Më 1 janar 2015	**(22,767,584)**	**(11,950,351)**	**(28,498,073)**	**(457,972,839)**	**(521,188,847)**
Amortizimi për vitin	(3,137,953)	(4,221,503)	(7,667,224)	(178,016,287)	(193,042,967)
Pakësime	-	-	7,610	-	7,610
Më 31 dhjetor 2015	**(25,905,537)**	**(16,171,854)**	**(36,157,687)**	**(635,989,126)**	**(714,224,204)**
Amortizimi për vitin	(3,162,083)	(4,032,701)	(4,376,573)	(56,345,191)	(67,916,548)
Më 31 dhjetor 2016	**(29,067,620)**	**(20,204,555)**	**(40,534,260)**	**(692,334,317)**	**(782,140,752)**
Vlera e mbetur neto					
Më 1 janar 2015	**12,814,602**	**9,152,062**	**11,857,248**	**411,244,861**	**445,068,773**
Më 31 dhjetor 2015	**9,749,791**	**4,939,309**	**6,464,388**	**284,485,863**	**305,639,351**
Më 31 dhjetor 2016	**6,587,708**	**1,364,988**	**8,789,981**	**231,766,700**	**248,509,377**

6 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

i. Ndryshime në vlerësime

Gjatë 2016, Shoqëria ka rishikuar jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata materiale, gjë që rezultoi në rritjen e jetëgjatësisë së vlerësuar të makinerive dhe pajisjeve teknike, duke përjashtuar aktivet e mbajtura në mjediset e palëve të treta (shih iii më poshtë), nga 5 deri në 10 vjet. Efekti i këtij ndryshimi në shpenzimin aktual dhe të ardhshëm të amortizimit është si më poshtë:

Viti i mbyllur më 31 dhjetor	(Ulje)/rritje në shpenzimin e amortizimit
2016	(130,712,234)
2017	(22,083,818)
2018	32,402,196
2019	29,880,030
2020	32,163,736
Në të ardhmen	58,350,090

ii. Provizione për kostot e çmontimit

Provizionet për kostot e çmontimit rezultojnë nga kontratat e qirasë dhe përbëhen nga shpenzime të ardhshme te përllogaritura për t'u kryer nga Shoqëria në përfundim të kontratës se qirasë të skontuar me normën e interesit të huave. Lëvizja e provizioneve për kostot e çmontimit paraqitet si më poshtë:

Kostot e çmontimit	2016	2015
Më 1 janar	455,965	418,688
Efekti i skontimit të provizionit	78,830	37,277
Më 31 dhjetor	**534,795**	**455,965**

iii. Aktivet e mbajtura në ambientet e palëve të treta

Makineri e pajisje teknike me vlerë të mbartur prej 50,197,269 Lek (2015: 58,658,671 Lek) përfaqësojnë aktive të Shoqërisë të cilat bazuar në Marrëveshjen e Koncesionit u jepen klientëve falas, instalohen në ambientet e tyre dhe përdoren për verifikimin e origjinalitetit të pullave.

7 Aktive afatgjata jo materiale

	Program kontabiliteti
Kosto	
Më 1 janar 2015	**94,132**
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2015	**94,132**
Shtesa	**-**
Më 31 dhjetor 2016	**94,132**
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 dhjetor 2015	**(33,338)**
Amortizimi i vitit	(23,533)
Më 31 dhjetor 2015	**(56,871)**
Amortizimi i vitit	(23,533)
Më 31 dhjetor 2016	**(80,404)**
Vlera neto	
Më 1 janar 2015	**60,794**
Më 31 dhjetor 2015	**37,261**
Më 31 dhjetor 2016	**13,728**

8 Aktive tatimore të shtyra

Lëvizja në tatimin e shtyrë është si më poshtë:

	2016	2015
Më 1 janar	32,273,841	21,072,608
(Shpenzimi)/e ardhura nga tatimi i shtyrë	(5,837,579)	11,201,233
Aktive tatimore të shtyra	**26,436,262**	**32,273,841**

Aktivet tatimore të shtyra janë llogaritur me normën e tatim-fitimit prej 15% (2015:15%). Aktivet tatimore të shtyra u njohën për diferencat mes metodave të ndryshme të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale (AAM) për qëllimet kontabël dhe fiskale; shpenzimeve të nisjes (të cilat njihen si aktive vetëm për arsye fiskale); kostove të çmontimit (të cilat njihen si aktive vetëm për arsye kontabël); zhvlerësimet e inventarit; provizioneve për kostot e çmontimit; dhe detyrime të përllogaritura si më poshtë:

Aktive tatimore të shtyra	AAM	Inventar	Provizione	Të tjera	Total
Më 1 janar 2015	**19,110,304**	**248,773**	**62,803**	**1,650,728**	**21,072,608**
Lëvizje	11,095,688	(203,280)	5,592	303,233	11,201,233
Më 31 dhjetor 2015	**30,205,992**	**45,493**	**68,395**	**1,953,961**	**32,273,841**
Lëvizje	(5,496,238)	(35,072)	11,824	(318,093)	(5,837,579)
Më 31 dhjetor 2016	**24,709,754**	**10,421**	**80,219**	**1,635,868**	**26,436,262**

9 Inventari

	2016	2015
Produkte të gatshme	70,630,342	78,188,267
Lëndët e para dhe të konsumit	50,816,247	63,000,197
Minus: Rënie në vlerë	(69,476)	(303,286)
Më 31 dhjetor	**121,377,113**	**140,885,178**

Lëvizjet në provizionin për skrap të inventarit ishin si më poshtë:

	2016	2015
Më 1 janar	303,286	7,806,489
Rimarrje	(303,286)	(7,806,489)
Rënie në vlerë të inventarit	69,476	303,286
Më 31 dhjetor	**69,476**	**303,286**

Gjate vitit 2016 Shoqëria ka nxjerrë jashtë përdorimit vlerën e inventarit prej 2,486,149 Lek (2015: 5,045,752 Lek). Të gjithë rëniet deri në vlerën e realizueshme neto të inventarit si edhe rimarrje të këtyre rënieve në vlerë përfshihen në koston e mallrave të shitur.

10 Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

	2016	2015
Të arkëtueshme nga SICPA SA	141,111,290	5,672,262
Llogari tregtare të arkëtueshme	756,527	12,142,750
Më 31 dhjetor	**141,867,817**	**17,815,012**

Të arkëtueshmet nga SICPA SA përfshijnë shumën prej 140,641,585 Lek (2015: zero) e cila përfaqëson kontributet e pranuara dhe të arkëtueshme nga SICPA SA në mbështetje të fazës së nisjes dhe humbjeve të Shoqërisë për vitet 2014 dhe 2015. Këto kontribute janë faturuar nga Shoqëria për SICPA SA në dhjetor 2016 dhe janë njohur në kapital, dhe marrëveshja përkatëse midis palëve u nënshkrua në qershor 2017 (shënimi 28).

11 Parapagime dhe aktive të tjera

	2016	2015
Parapagime për shërbime	4,855,899	4,833,637
Garanci bankare	1,893,642	1,893,642
Parapagime ndaj personelit	410,162	899,839
Më 31 dhjetor	**7,159,703**	**7,627,118**

Shumat krahasuese për llogaritë tregtare dhe të tjera të arkëtueshme si dhe për parapagimet dhe aktive të tjera më 31 dhjetor 2015 janë riparaqitur në përputhje me paraqitjen e vitit aktual.

12 Mjete monetare dhe ekuivalentë

	2016	2015
Mjete monetare në arkë:		
Në Lek	59,847	20,900
Në Euro	54,092	-
	113,939	**20,900**
Llogari rrjedhëse në bankë:		
Në Lek	60,837	846,621
Në Euro	27,669,890	54,726,018
	27,730,727	**55,572,639**
Më 31 dhjetor	**27,844,666**	**55,593,539**

13 Huatë

	2016	2015
Afatgjatë:		
Hua nga SICPA Holding SA	-	391,248,000
	-	**391,248,000**
Afatshkurtër:		
Hua nga SICPA Holding SA	193,378,900	-
Interesa dhe tarifa angazhimi të përllogaritura	4,010,501	8,097,168
	197,389,401	8,097,168
Më 31 dhjetor	**197,389,401**	**399,345,168**

Një hua me vlerë 4 milion Euro i është dhënë Shoqërisë nga SICPA Holding SA për t'u disbursuar në transhe. Huaja fillimisht kishte maturitet dy vjeçar dhe ishte e pagueshme brenda datës 11 mars 2013. Gjatë vitit 2012 u nënshkrua një shtesë e kontratës dhe u aprovua një shtyrje e pagimit të kredisë deri në 19 prill 2015. Bazuar në ndryshimin e marrëveshjes datë 30 mars 2015, pagimi i huasë është shtyrë deri me 19 prill 2017.

13 Huatë (vazhdim)

Një ndryshim tjetër i marrëveshjes i datës 17 janar 2017 parashikon që shlyerja e kredisë të zgjatet deri më 19 prill 2018 (shënimi 28).

Interesat dhe angazhimet e përllogaritura në 31 dhjetor 2016, përfaqësojnë interesat e vonuara qe pritet të shlyhen brenda vitit pasardhës. Huaja është marrë në Euro dhe mbart një normë interesi vjetore prej 8.00% (2015: 8.00%). Nuk ka pasur disbursime të reja gjatë 2016 dhe 2015. Një tarifë angazhimi prej 1.3% në vit është ngarkuar mbi pjesën e pa tërhequr të huasë deri më 1 prill 2016, datë pas së cilës, në bazë të ndryshimit të marrëveshjes të datës 17 janar 2017, SICPA Holding SA hoqi dorë nga tarifa e angazhimit (shënimi 28). Gjatë vitit 2016 ka pasur shlyerje të pjesshme të huasë në shumën 1.42 milion Euro (2015: 0.7 milion Euro).

14 Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera

	2016	2015
SICPA SA	127,347,366	110,170,705
Furnitorë të tjerë	4,956,152	6,330,765
SICPA Holding SA	20,665,863	3,852,100
Më 31 dhjetor	**152,969,381**	**120,353,570**

15 Tarifa e koncesionit e pagueshme

	2016	2015
Më 1 janar	17,190,658	17,316,117
Pagesa gjatë vitit	(17,190,658)	(17,316,117)
Tarifa e koncesionit e llogaritur për vitin	16,215,798	17,190,658
Më 31 dhjetor	**16,215,798**	**17,190,658**

Prodhimi dhe shitja e pullave fiskale ka filluar prej 2012, edhe pse Data Efektive siç ishte përcaktuar nga Marrëveshja e Koncesionit (shënimi 1) nuk ishte arritur akoma. Duke ju referuar Marrëveshjes së Koncesionit, Shoqëria detyrohet t'i paguajë Autoritetit një tarifë koncesioni prej 2% të totalit vjetor të të ardhurave neto nga shitja e pullave fiskale. Tarifa e përllogaritur e koncesionit prej 17,190,658 Lek u pagua gjatë vitit 2016. Tarifa e përllogaritur e koncesionit për vitin 2016 është në vlerën 16,215,798 Lek dhe pritet të paguhet në 2017.

16 Detyrime të tjera

	2016	2015
Shpenzime të përllogaritura	10,108,627	10,498,188
Detyrime tatimore lidhur me personelin	3,250,967	2,887,944
Tatim i pagueshëm mbi vlerën e shtuar	3,078,172	11,029,169
Të ardhura të shtyra	1,078,473	10,415,135
Provizione	719,821	-
Tatimi i pagueshëm në burim	201,997	844,186
Më 31 dhjetor	**18,438,057**	**35,674,622**

Detyrimet e përllogaritura prej 10,108,627 Lek (2015: Lek 10,498,188) përbëhen kryesisht nga shpërblimet e përllogaritura për punonjësit dhe për shërbimet utilitare dhe profesionale.

Të ardhurat e shtyra prej 1,078,472 Lek (2015: Lek 10,415,135) përbëhen nga shitjet e faturuara për konsumatorët, por që nuk janë njohur si të ardhura pasi dërgesa nga vendi i prodhimit drejt klientit ka ndodhur pas 31 dhjetor 2016.

17 Kapitali i nënshkruar

Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, kapitali i nënshkruar i Shoqërisë ishte 466,337,321 Lek, i zotëruar 100% nga SICPA SA (shënimi 1) dhe i përbërë nga një kuotë me vlerë nominale 466,337,321 Lek.

18 Të ardhura operative

Të ardhurat operative për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2016 në shumën prej 820,126,542 Lek (2015: 851,268,693 Lek) përbëhen nga shitja e pullave fiskale

19 Të ardhura të tjera

Gjatë vitit 2016, Shoqëria ka ringarkuar drejt SICPA Security Solutions SA shumën prej 3,391,932 Lek (2015: 6,047,642 Lek) për shpenzimet e udhëtimit të mbartura nga stafi gjatë udhëtimit të biznesit te cilat paguhen nga Shoqëria mëmë.

20 Kosto e mallrave të shitur

Kosto e mallrave të shitur për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2016 është në vlerën e 339,942,959 Lek (2015: 353,522,320 Lek)

Shoqëria ka përllogaritur koston e mallrave të shitura duke përdorur metodën e kostos standarde. Diferencat periodike janë analizuar nga Shoqëria për të bërë krahasimin e kostos aktuale me koston standarde dhe nga ky krahasim nuk kanë rezultuar diferenca të rëndësishme.

Kostot e transportit të mallrave të shitura i ngarkohen klientëve të Shoqërisë sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Koncesionit dhe janë përfshirë në koston e mallrave të shitur në bazë neto.

21 Furnizime dhe shërbime

	2016	2015
Shërbime mbështetëse nga SICPA	41,086,500	41,797,500
Shpenzime qiraje	16,190,781	16,459,907
Shpenzime të ndryshme	10,599,518	11,495,094
Shpenzime konsulence	7,250,304	4,707,348
Shpenzime qiraje për automjete	6,565,842	6,891,494
Shpenzime udhëtimi	6,194,651	10,622,277
Shpenzime mirëmbajtje	5,803,721	3,132,617
Taksa doganore dhe taksa lokale	3,792,601	4,578,053
Shërbime profesionale	3,617,238	1,606,512
Shpenzime komunale (energji elektrike, ujë, gaz, etj.)	3,270,232	3,185,249
Shpenzime sigurimi	3,106,162	3,442,266
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	3,008,308	3,889,975
Kosto të lidhura me programe kompjuterike	2,068,166	795,902
Shpenzime përfaqësimi	1,351,065	18,860
Provizione për gjoba fiskale	719,821	-
Shpenzime për shkatërrimin e mallrave	331,515	288,438
Shpenzime rekrutimi	110,000	110,000
Humbje nga çregjistrimi i aktiveve	-	33,899
	115,066,425	**113,055,391**

22 Shpenzime për personelin

	2016	2015
Pagat	122,384,786	127,024,983
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	8,627,043	8,970,463
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore vullnetare	1,352,807	1,190,188
	132,364,636	**137,185,634**

23 Honorare për të drejtat e autorit

Honorare për të drejtat e autorit prej 42,640,911 Lek (2015: 45,195,565 Lek) u përllogaritën bazuar në të ardhurat neto dhe janë të pagueshme ndaj SICPA SA për të drejtat e përdorimit të emrit tregtar, proceset e planifikimit dhe prodhimit si dhe për informacione që kanë lidhje me eksperiencën tregtare dhe industriale.

24 Shpenzime financiare, neto

	2016	2015
Të ardhura financiare:		
Të ardhura nga interesi i llogarive bankare	64	708
Fitime neto nga kursi i këmbimit	5,338,745	12,224,571
	5,338,809	**12,225,279**
Shpenzime financiare:		
Interesa dhe tarifa të angazhimit mbi huatë	(26,285,732)	(38,241,900)
Komisione bankare dhe komisione për garanci	(702,171)	(897,452)
Efekti e skontimit të provizionit	(78,830)	(37,277)
	(27,066,733)	**(39,176,629)**
Shpenzime financiare neto	**(21,727,924)**	**(26,951,350)**

25 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimin i tatim-fitimit është si më poshtë:

	2016	2015
Tatim fitimi aktual		
Shpenzimi për tatim-fitimin e vitit	(9,950,425)	(12,293,824)
Rregullime të tatim-fitimit për periudhat e mëparshme	(9,832,487)	-
	(19,782,912)	**(12,293,824)**
Tatim fitimi i shtyrë		
(Shpenzimi)/ e ardhura nga tatimi i shtyrë (shënimi 8)	(5,837,579)	11,201,232
	(5,837,579)	**11,201,232**
Totali	**(25,620,491)**	**(1,092,592)**

Rregullimet e tatim-fitimit për periudhat e mëparshme prej 9,832,487 Lek (2015: zero) përbëhen nga tatimi shtesë i pagueshëm për vitet 2014 dhe 2015 përkatësisht në shumat 1,158,085 Lek dhe 8,674,402 Lek, pas ndryshimeve të deklaratës së tatim-fitimit të atyre viteve, në lidhje me disa rivlerësime të rezultuara nga analiza e bërë nga një ekspert i jashtëm gjatë vitit 2016.

Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, Shoqëria nuk kishte humbje të mbartura tatimore. Norma e tatimit mbi të ardhurat për vitin 2016 është 15% (2015: 15%). Në vijim paraqitet një barazim midis tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën në fuqi dhe shpenzimit të tatimit mbi fitimin:

	Norma efektive e tatimit	2016	Norma efektive e tatimit	2015
Fitimi(Humbja) para tatimit për vitin		87,619,740		(28,851,083)
Tatimi mbi fitimin me normën në fuqi	15.00%	13,142,961	15.00%	(4,327,662)
Shpenzime të panjohura	3.02%	2,645,043	(18.79%)	5,420,254
Korrigjime për tatimin aktual të periudhave të mëparshme	11.22%	9,832,487	-	-
Tatim-fitimi	**29.24%**	**25,620,491**	**(3.79%)**	**1,092,592**

Tatimi i pagueshëm mbi fitimin më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është i përbërë si më poshtë:

	2016	2015
Më 1 janar	(11,122,574)	1,171,250
Shpenzimi i tatim-fitimit aktual për vitin (shënimi 25 më lart)	(19,782,912)	(12,293,824)
Tatim-fitimi i paguar gjatë vitit	21,613,829	-
Më 31 dhjetor	(9,291,657)	(11,122,574)

Tatim-fitimi i paguar gjatë vitit 2016 përfshin një shumë prej 141,250 Lek e cila aktualisht është në pritje të konfirmimit nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Tatimpaguesve të Mëdhenj në mënyrë që Shoqëria ta përdorë atë në periudhat e ardhshme.

26 Angazhime, garanci dhe detyrime të mundshme

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime dhe procese gjyqësore të ndryshme. Drejtimi i Shoqërisë është i mendimit se kosto përfundimtare e zgjidhjes së këtyre çështjeve nuk do të ketë një efekt material në pozicionin financiar të Shoqërisë apo ndryshimet në aktivet neto, përveç atyre për të cilat janë njohur provizione në këto pasqyra financiare

Në maj të vitit 2015, Shoqëria iu nënshtrua një kontrolli tatimor nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve e Tatimpaguesve të Mëdhenj, e cila i vendosi Shoqërisë detyrime shtesë tatimore në shumën 1,388,735 Lek, gjobë në shumën 304,133 Lek si dhe reduktoi humbjen fiskale për 2012 për shumën prej 50,512,779 Lek. Vendimi u apelua nga Shoqëria përmes kërkesës së kundërshtimit drejtuar Drejtorisë së Apelimit të Tatimeve. Drejtoria e Apelimit Tatimor gjykoi në favor të Shoqërisë dhe për rrjedhojë u shfuqizuan detyrimet prej 1,388,735 Lek, gjoba prej 304,133 Lek, si dhe reduktimi i humbjes fiskale për vitin 2012 për shumën prej 43,707,641 Lek. Megjithatë, Drejtoria e Apelimit Tatimor ka lënë në fuqi reduktimin e humbjes fiskale për vitin 2012 për shumën prej 6,805,138 Lek. Vendimi i Drejtorisë së Apelimit të Taksave u ankimua nga Shoqëria në Gjykatën Administrative, e cila pranoi kërkesën e Shoqërisë. Më pas vendimi i Gjykatës Administrative të Tiranës u ankimua nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe aktualisht është në pritje të gjykimit nga Gjykata e Apelit.

Nga ana tjetër, Shoqëria është e përfshirë si një palë e tretë në procesin e gjykimit mes institucioneve brenda administratës tatimore. Vendimi i Drejtorisë së Apelimit Tatimor u kundërshtua nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Tatimpaguesve të Mëdhenj në Gjykatën Administrative të Tiranës, e cila gjithashtu gjykoi në favor të Shoqërisë. Vendimi i Gjykatës Administrative të Tiranës u ankimua nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe aktualisht është në pritje të gjykimit nga Gjykata e Apelit.

26 Angazhime, garanci dhe detyrime të mundshme (vazhdim)

Detyrime të mundshme tatimore

Legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri në fuqi ose që konsiderohet si i hyrë në fuqi në fund të 2016, është objekt i interpretimeve të ndryshme për sa i përket zbatimit të tij për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor i ndërmarrë nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbështet qëndrimet tatimore mund të kundërshtohet me sukses nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit. Nën rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Angazhime kapitale

Shoqëria nuk ka pasur shpenzime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara në datën e raportimit.

Angazhime të qirasë operative

Shoqëria mund të anuloje marrëveshjen e qirasë me një afat lajmërimi prej 1 muaji. Si rrjedhojë, më 31 dhjetor 2016, pagesat maksimale të pa anulueshme në lidhje me qiranë e pagueshme brenda periudhës një vjeçare janë 1,570,796 Lek (2015: 1,307,637 Lek).

27 Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen të jenë palë të lidhura nëse një palë ka mundësinë të kontrollojë ose të ushtrojë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë.

Në palët e lidhura me shoqërinë përfshihen SICPA SA, si pronar i vetëm i shoqërisë, SICPA Holding SA dhe Drejtimi i SICPA të cilët janë pjesë e grupit SICPA. Shoqëria ka kryer transaksione me palët e lidhura gjatë rrjedhës normale të biznesit. Volumi i këtyre transaksioneve dhe gjendjet në fund të periudhave përkatëse janë si më poshtë:

Të drejta ndaj palëve të lidhura

	2016	2015
SICPA SA (shënimi 10)	141,111,290	5,672,262
	141,111,290	**5,672,262**

Detyrimet ndaj palëve të lidhura	**2016**	**2015**
Pjesa afatgjatë		
SICPA Holding SA (shënimi 13)	-	391,248,000
	-	**391,248,000**
Pjesa afatshkurtër		
SICPA Holding SA (shënimi 13)	197,389,401	11,949,268
SICPA SA (shënimi 14)	127,347,366	110,170,705
SICPA Holding SA (shënimi 14)	20,665,863	3,852,100
	345,402,630	**125,972,073**
Totali	**345,402,630**	**517,220,073**

Transaksionet me palët e lidhura

Shpenzime	**2016**	**2015**
Honorare për të drejtat e autorit (shënimi 23)	42,640,911	45,195,565
Shërbime mbështetëse (shënimi 21)	41,086,500	41,797,500
Interesa huaje dhe tarifa angazhimi (shënimi 24)	26,285,732	38,241,900
Shërbime personeli	25,736,297	28,540,190
Tarifa për licencën e Microsoft (shënimi 21)	2,068,166	795,902
Totali	**137,817,606**	**154,571,057**

28 Ngjarje pas datës së raportimit

Një ndryshim i marrëveshjes së huasë me SICPA Holding SA (shënimi 13), datë 17 janar 2017 parashikon që shlyerja e kredisë zgjatet deri më 19 prill 2018. Përveç kësaj, ky ndryshim gjithashtu anulon ngarkimin e tarifës së angazhimit mbi pjesën e patërhequr të kredisë me 1.3% në vit duke filluar nga data 1 prill 2016 dhe, mbi këtë bazë, tarifat e angazhimit të njohura gjatë 2016 lidhen vetëm me tremujorin e parë të vitit 2016.

Në qershor 2017, Shoqëria nënshkroi një marrëveshje me SICPA SA për kontributet e arkëtueshme në shumën 140,641,585 Lek në mbështetje të humbjeve të Shoqërisë gjatë fazës së nisjes në vitet 2014 dhe 2015 (shënimi 10). Kjo shumë u faturua nga Shoqëria gjatë vitit 2016 dhe me finalizimin e kontratës midis palëve, pritet të shlyhet me kompensim kundrejt huave nga SICPA Holding SA (shënimi 27) gjatë vitit 2017.

Gjithashtu, në qershor 2017, Shoqëria ndryshoi deklaratat e tatimit mbi fitimin për vitet 2014 dhe 2015 duke njohur një shumë prej 9,832,487 Lek si shpenzim shtesë tatimi aktual mbi fitimin në lidhje me vitet e mëparshme (shënimi 25).